

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 570 (I RISHIKUAR)

VIJIMËSIA

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Baza Kontabël e Vijimësisë	2
Përgjegjësia për Vlerësimin e Aftësisë së Entitetit për të Vazhduar në Vijimësi	3-7
Hyrja në fuqi	8
Objektivat	9
Kërkesat	
Procedurat për Vlerësimin e Rrezikut dhe Veprimtaritë Përkatëse	10-11
Shqyrtimi i Vlerësimeve të Drejtimit	12-14
Periudha Përtej Vlerësimeve të Drejtimit	15
Procedurat e Mëtejshme të Auditimit kur Janë Identifikuar Ngjarje apo Rrethana	16
Konkluzionet e Audituesit	17-20
Pasojat në Raportin e Audituesit	21-24
Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen	25
Vonesa të Theksuara në Miratimin e Pasqyrave Financiare	26
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Objekti i Këtij SNA-je	A1
Baza e Kontabël e Vijimësisë	A2
Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Veprimtaritë Përkatëse	A3-A7
Çmuarja e Vlerësimit të Drejtimit	A8-A13
Periudha Përtej Vlerësimeve të Drejtimit	A14-A15
Procedurat e Mëtejshme të Auditimit kur janë Identifikuar Ngjarje apo Rrethana	A16-A20
Konkluzionet e Audituesit	A21-A25
Pasojat në raportin e Audituesit	A26-A35
Shtojcë: Ilustrime të Raportit të Audituesit Lidhur me Vijimësinë	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 570 (I rishikuar), “*Vijimësia*” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësinë e audituesit në auditimin e pasqyrave financiare përsa i përket vijimësisë dhe pasojave në raportin e audituesit.

Baza Kontabël e Vijimësisë

2. Sipas bazës kontabël të vijimësisë, pasqyrat financiare janë përgatitur sipas hipotezës që entiteti është në vijimësi dhe do të vazhdojë veprimtaritë e tij për një të ardhme të parashikueshme. Pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme përgatiten mbi bazën kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ose ka synime ta likuidojë entitetin ose të ndërpresë veprimtaritë e tij, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër veçse të bëjë këtë. Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta mundet të përgatiten ose jo në përputhje me kuadrin e raportimit financiar për të cilin baza kontabël e vijimësisë është e rëndësishme (për shembull, baza kontabël e vijimësisë nuk është e rëndësishme për disa pasqyra financiare që përgatiten për qëllime tatimore në disa juridiksione). Kur përdorimi i bazës kontabël të vijimësisë është i përshtatshëm, aktivet dhe detyrimet regjistrohen mbi bazën se entiteti do të ketë aftësinë të realizojë aktivet e tij dhe të shlyejë detyrimet e tij përgjatë rrjedhës normale të biznesit. (Ref: Para. A2)

Përgjegjësia për Vlerësimin e Aftësisë së Entitetit për të Vazhduar në Vijimësi

3. Disa kuadro të raportimit financiar përmbajnë një kërkesë të veçantë për drejtimin që të bëjë një vlerësim të veçantë të aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi në të ardhmen dhe standarde për çështjet që duhet të merren në konsideratë dhe informacionet që duhet të jepen në lidhje me vijimësinë. Për shembull, Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 1 i kërkon drejtimin që të bëjë një vlerësim të aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi.¹ Kërkesa të hollësishme, në lidhje me përgjegjësinë e drejtimin për të vlerësuar aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi dhe informacionet që jepen në pasqyrat financiare, gjithashtu mund të parashikohen edhe nga legjislacioni apo rregulloret.
4. Në kuadro të tjera të raportimit financiar, mund të mos kërkohej në mënyrë specifike që drejtimi të bëjë një vlerësim të aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi. Pavarësisht nga kjo, atje ku baza kontabël e vijimësisë është një parim themelor në përgatitjen e pasqyrave financiare, siç parashikohet në paragrafin 2, përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të vlerësojë aftësinë e entitetit për të

¹ Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* siç është në botimin e 1 janar 2009, paragrafët 25-26.

vazhduar në vijimësi edhe në qoftë se kuadri i raportimit financiar nuk përmban një kërkesë të veçantë për ta bërë një gjë të tillë.

5. Vlerësimi i drejtimit në lidhje me aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi përmban bërjen e një gjykimi, në një moment të caktuar në kohë, rreth rezultateve të ardhshme të pasigurta e të vetvetishme të ngjarjeve apo të kushteve. Faktorët e mëposhtëm janë të rëndësishëm për këtë gjykim:
 - Shkalla e pasigurisë që shoqëron rezultatet e ngjarjeve apo kushteve rritet ndjeshëm kur ndodhja e këtyre ngjarjeve apo kushteve ose rezultateve të tyre largohet në kohë. Për këtë arsye, shumë nga kuadrot e raportimit financiar që kërkojnë një vlerësim specifik nga ana e drejtimit, përcaktojnë edhe periudhën për të cilën drejtimi duhet të marrë në konsideratë të gjithë informacionin e disponueshëm.
 - Madhësia dhe kompleksiteti i entitetit, natyra dhe kushtet e veprimtarisë dhe shkalla me të cilën ai ndikohet nga faktorët e jashtëm, të gjitha këto ndikojnë në gjykimin e rezultateve të ngjarjeve apo rrethanave.
 - Çdo gjykim në lidhje me të ardhmen bazohet në informacionin që është i disponueshëm në kohën kur bëhet gjykimi. Ngjarje të mëvonshme mund të kompromentojnë një gjykim i cili për kohën që është bërë ishte i arsyeshëm.

Përgjegjësitë e Audituesit

6. Përgjegjësitë e audituesit janë të sigurojë evidencë auditimi të mjaftueshme e të përshtatshme dhe të nxjerrë përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e zbatimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, të arrijë në përfundimin nëse ekziston një pasiguri materiale rreth aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi. Këto përgjegjësi ekzistojnë edhe në qoftë se kuadri i raportimit financiar i zbatuar për përgatitjen e pasqyrave financiare nuk përmban një kërkesë të veçantë për drejtimin që të bëjë një vlerësim specifik të aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi veprimtarinë në të ardhmen.
7. Megjithatë, siç parashikohet në SNA 200,² efektet e mundshme të kufizimeve të vetvetishme të aftësisë së audituesit për të zbuluar anomalitë materiale janë më të mëdha për ngjarjet apo kushtet në të ardhmen, të cilat mund të shkaktojnë që entiteti të ndërpresë vazhdimin e veprimtarisë. Audituesi nuk mund të parashikojë këto ngjarje apo kushte në të ardhmen. Në përputhje me rrethanat, mungesa e ndonjë referencë ndaj një pasigurie materiale rreth aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi, në raportin e audituesit nuk mund të konsiderohet si një garanci e aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi.

² SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafët A53-A54.

Data e Hyrjes në Fuqi

8. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që përfundojnë në ose pas datës 15 Dhjetor 2016.

Objektivat

9. Objektivat e audituesit janë:

- (a) Të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe të nxjerrë përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare;
- (b) Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, të arrijë në përfundimin nëse ekzistojnë pasiguri materiale që lidhen me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi; dhe
- (c) Të raportojë në përputhje me këtë SNA.

Kërkesat**Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Veprimtaritë Përkatëse**

10. Kur kryen procedurat e vlerësimit të rrezikut siç parashikohet në SNA 315 (i rishikuar),³ audituesi merr në konsideratë faktin nëse ekzistojnë ngjarje apo kushte që hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Duke bërë këtë, audituesi përcakton nëse drejtimi ka kryer tashmë një vlerësim paraprak apo jo të aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi dhe: (Ref: Para. A3-A6)

- (a) Në qoftë se ky vlerësim është kryer, audituesi diskuton vlerësimin me drejtimin dhe përcakton nëse drejtimi ka identifikuar ngjarje apo kushte të cilat, veças ose sëbashku, mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi dhe, në qoftë se është kështu, planet e drejtimit për t'i trajtuar ato; ose
- (b) Në qoftë se ky vlerësim nuk është kryer, audituesi diskuton me drejtimin bazat për zbatimin e synuar të bazës kontabël të vijimësisë dhe pyet drejtimin nëse ekzistojnë ngjarje apo kushte të cilat, veças ose sëbashku, mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi.

³ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij*, paragrafi 5.

11. Audituesi mbetet në gatishmëri gjatë gjithë auditimit për evidencë auditimi të ngjarjeve dhe kushteve të cilat mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. (Ref: Para. A7)

Çmuarja e Vlerësimit të Drejtimit

12. Audituesi çmon vlerësimin e drejtimit për aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. (Ref: Para. A8-A10, A12-A13)

13. Në çmuarjen e vlerësimit të drejtimit për aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, audituesi duhet të përfshijë të njëjtën periudhë me atë të zbatuar nga drejtimi për të bërë vlerësimin e tij siç kërkohet nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, ose nga legjislacioni apo rregulloret në qoftë se ai parashikon një periudhë më të gjatë. Në qoftë se vlerësimi i drejtimit për aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi përfshin më pak se dymbëdhjetë muaj nga data e pasqyrave financiare siç parashikohet nga SNA 560,⁴ audituesi i kërkon drejtimit të zgjerohë periudhën e vlerësimit të tij deri në të paktën dymbëdhjetë muaj nga kjo datë. (Ref: Para. A11-A13)

14. Në çmuarjen e vlerësimit të drejtimit, audituesi merr në konsideratë nëse drejtimi ka përfshirë të gjithë informacionin e duhur për të cilin audituesi është në dijeni si rezultat i auditimit.

Periudha përtej Vlerësimit të Drejtimit

15. Audituesi pyet drejtuesit bazuar në njohjen e tij të ngjarjeve apo kushteve përtej periudhës së vlerësimit të drejtimit që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. (Ref: Para. A14-A15)

Procedura Auditimi Shtesë Kur Identifikohen Ngjarje apo Kushte

16. Në qoftë se janë identifikuar ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, audituesi merr evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të përcaktuar nëse ekziston apo jo ndonjë pasiguri materiale e lidhur me ngjarje apo kushte të cilat mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi (këtu e më poshtë referimi si “pasiguri materiale”) duke kryer procedura auditimi shtesë, përfshirë marrjen në konsideratë edhe të faktorëve lehtësues. Këto procedura përfshijnë: (Ref: Para. A16)

(a) Kur drejtimi nuk ka kryer ende një vlerësim mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, duke i kërkuar drejtimit të bëjë vlerësimin e tij.

⁴ SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme*, paragrafi 5(a).

- (b) Vlerësimin e planeve të drejtimit për veprime në të ardhmen në lidhje me vlerësimin e tij të hipotezës së vijimësisë, nëse rezultatet e këtyre planeve ka të ngjarë që të përmirësojnë situatën dhe nëse planet e drejtimit janë të zbatueshëm për rrethanat. (Ref: Para. A17)
- (c) Kur entiteti ka përgatitur një parashikim të flukseve të parave dhe analiza e parashikimit është faktor i rëndësishëm në marrjen në konsideratë të rezultateve në të ardhmen të ngjarjeve apo kushteve për vlerësimin e planeve të drejtimit mbi veprimet në të ardhmen: (Ref: Para. A18-A19)
- (i) Duke vlerësuar besueshmërinë e të dhënave bazë të gjeneruara për të përgatitur parashikimin; dhe
 - (ii) Duke përcaktuar nëse ka apo jo mbështetje të përshtatshme për supozimet bazë të parashikimit.
- (d) Duke marrë në konsideratë çdo fakt apo informacion tjetër që është bërë i disponueshëm qysh nga data në të cilën drejtimi ka bërë vlerësimin e tij.
- (e) Duke kërkuar deklarime me shkrim nga drejtimi dhe, kur është e nevojshme, nga ata që janë ngarkuar me qeverisjen, në lidhje me planet e tyre për veprime në të ardhmen dhe zbatueshmërinë e këtyre planeve. (Ref: Para. A20)

Konkluzionet e Audituesit

17. Audituesi do të vlerësojë nëse është siguruar evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme auditimi dhe duhet të nxjerrë përfundime mbi përshtatmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.
18. Bazuar në evidencën e marrë të auditimit, audituesi konkludon nëse, sipas gjykimit të audituesit, ekziston pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte të cilat, veças apo së bashku, mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Një pasiguri materiale ekziston kur gjerësia e ndikimit të saj të mundshëm dhe probabiliteti i ndodhjes është i tillë që, sipas gjykimit të audituesit, dhënia e informacionit të përshtatshëm të natyrës dhe pasojave të pasigurisë janë të nevojshme për: (Ref: Para. A21-A22)
- (a) Në rastin e kuadrit të raportimit financiar të paraqitjes me vërtetësi, është paraqitja me vërtetësi e pasqyrave financiare, ose
 - (b) Në rastin e kuadrit të përputhjes, është që pasqyrat financiare nuk duhet të jenë çorientuese.

Mjaftueshmëria e Informacioneve shpjeguese kur janë Identifikuar Ngjarje ose Kushte dhe Ekziston një Pasiguri Materiale

19. Në qoftë se audituesi konkludon se zbatimi i bazës kontabël të vijimësisë është i përshtatshëm për rrethanat por ekziston një pasiguri materiale, audituesi duhet të përcaktojë nëse pasqyrat financiare: (Ref: Para. A22-A23)

- (a) Përshkruajnë në mënyrë të mjaftueshme ngjarjet apo kushtet kryesore që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi dhe planet e drejtimit trajtojnë këto ngjarje apo kushte; dhe
- (b) Jepen qartë informacionet që ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte të cilat hedhin dyshime mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi dhe, si rrjedhim ai nuk mund të realizojë aktivet e tij dhe të shlyejë detyrimet në rrjedhën normale të veprimtarisë. (Ref: Para. A20)

Mjaftueshmëria e Informacioneve shpjeguese kur janë Identifikuar Ngjarje ose Kushte por Nuk Ekziston Pasiguri Materiale

20. Në qoftë se janë identifikuar ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, por bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi arrin në përfundimin që nuk ekziston pasiguri materiale, audituesi duhet të vlerësojë nëse në funksion të kërkesave të zbatueshme të kuadrit të raportimit financiar, pasqyrat financiare kanë shpjegime të mjaftueshme të këtyre ngjarjeve dhe kushteve. (Ref: Para. A24-A25)

Implikimet/Pasojat në Raportin e Audituesit

Përdorimi i Bazës Kontabël të Vijimësisë është i Papërshtatshëm

21. Në qoftë se pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën kontabël të vijimësisë por, sipas gjykimit të audituesit, zbatimi nga drejtimi i bazës kontabël të vijimësisë në pasqyrat financiare nuk është i përshtatshëm, audituesi shpreh një opinion kundër. (Ref: Para. A26-A27)

Përdorimi i Bazës Kontabël të Vijimësisë është i Përshtatshëm por Ekziston një Pasiguri Materiale

Në Pasqyrat Financiare janë dhënë Informacionet e Duhura shpjeguese për një Pasiguri Materiale

22. Në qoftë se në pasqyrat financiare janë dhënë informacionet e duhura shpjeguese rreth pasigurisë materiale, audituesi shpreh një opinion pa rezervë dhe përfshin një seksion të veçantë të titulluar “Pasiguri Materiale të lidhura me Vijimësinë” për të: (Ref: Para. A28-A31, A34)

- (a) Tërhequr vëmendjen lidhur me shënimin në pasqyrat financiare që jep informacion për çështjen siç parashikohet në paragrafin 19; dhe
- (b) Deklaruar se këto ngjarje ose kushte tregojnë se ekziston një pasiguri materiale, e cila mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi dhe se opinioni i audituesit nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Në Pasqyrat Financiare Nuk janë dhënë Informacionet e Duhura shpjeguese për një Pasiguri Materiale

23. Në qoftë se në pasqyrat financiare nuk është dhënë informacioni i duhur shpjegues rreth pasigurisë materiale, audituesi duhet të:

- (a) Shprehë një opinion me rezervë ose opinion kundër, sipas rastit, në përputhje me SNA 705 (i rishikuar)⁵; dhe
- (b) Në Seksionin e Bazës për Opinionin me rezervë (Kundër) të Raportit të Audituesit, të deklarojë që ka një pasiguri materiale e cila mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi dhe se pasqyrat financiare nuk kanë informacionet e duhura shpjeguese për këtë çështje.

Drejtimi nuk Pranon të Bëjë ose të Zgjerojë Vlerësimin e Tij

24. Në qoftë se drejtimi nuk pranon të bëjë ose të zgjerojë vlerësimin e tij kur i kërkohet ta bëjë këtë nga audituesi, audituesi merr në konsideratë pasojat për t'u paraqitur në raportin e audituesit. (Ref: Para. A35)

Komunikimi me Ata që Janë Ngarkuar me Qeverisjen

25. Përveç rastit kur ata që janë ngarkuar me qeverisjen janë përfshirë në drejtimin e entitetit,⁶ audituesi komunikon me ata që janë ngarkuar me qeverisjen, ngjarjet apo kushtet e identifikuar të cilat mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Këto komunikime me ata që janë ngarkuar me qeverisjen përfshijnë sa më poshtë:

- (a) Nëse ngjarjet apo kushtet përbëjnë pasiguri materiale;
- (b) Nëse zbatimi i bazës kontabël të vijimësisë është i papërshtatshëm në përgatitjen e pasqyrave financiare;
- (c) Përshtatshmërinë e informacioneve të dhëna përkatëse në pasqyrat financiare; dhe

⁵ SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

⁶ SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 13.

(d) Kur është e zbatueshme, pasojat për raportin e audituesit.

Vonesa të Tepruara për Miratimin e Pasqyrave Financiare

26. Në qoftë se ka vonesa të tepruara në miratimin e pasqyrave financiare nga drejtimi ose nga ata që janë ngarkuar me qeverisjen mbas datës së pasqyrave financiare, audituesi pyet për arsyet e vonesës. Në qoftë se audituesi beson se vonesa është e lidhur me ngjarje apo kushte që kanë të bëjnë me vlerësimin e vijimësisë, audituesi kryen procedura shtesë të nevojshme, siç parashikohen në paragrafin 16, si edhe merr në konsideratë efektin në konkluzionin e audituesit në lidhje me ekzistencën e pasigurisë materiale, siç parashikohet në paragrafin 18.

* * *

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Objekti i këtij standardi (Ref: Para. 1)

A1. SNA 701⁷ ka të bëjë me përgjegjësinë e audituesit për të komunikuar çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit. Ky SNA pranon që kur zbatohet SNA 701, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë mund të përcaktohen si çështje kryesore të auditimit dhe shpjegon se një pasiguri materiale që lidhet me ngjarjet ose kushtet mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, që për nga natyra e saj, është një çështje kryesore e auditimit⁸.

Baza e Kontabël e Vijimësisë (Ref: Para. 2)

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

A2. Përdorimi nga drejtimi i bazës kontabël të vijimësisë është gjithashtu i rëndësishëm për entitetet e sektorit publik. Për shembull, Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) 1 trajton çështjen e aftësisë së entiteteve të sektorit publik për të vazhduar në vijimësi.⁹ Rreziqet e vijimësisë mund të vijnë nga, por nuk kufizohen vetëm me, situatat kur entitetet e sektorit publik operojnë mbi baza fitimi, rastet kur mbështetja qeveritare mund të reduktohet ose të ndërpritet, ose në rastin e privatizimit. Ngjarjet apo kushtet që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi në sektorin publik mund të përfshijnë situata ku entiteti në sektorin publik ka mungesë fondesh për të vazhduar ekzistencën e tij apo kur janë marrë vendime politike të cilat ndikojnë në shërbimet e dhëna nga entiteti në sektorin publik.

⁷ SNA 701, *Komunikimi i çështjeve të rëndësishme të auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

⁸ Shiko paragrafin 15 dhe A41 të SNA 701.

⁹ SNKSP 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, sipas botimit më 1 janar 2009, paragrafët 38-41.

Procedurat e Vlerësimit të Rrezikut dhe Veprimet Përkatëse

Ngjarjet apo Kushtet që Mund të Hedhin Dyshime të Rëndësishme mbi Aftësinë e Entitetit për të Vazhduar në Vijimësi (Ref: Para. 10)

A3. Më poshtë jepen shembuj të ngjarjeve apo kushteve të cilat, veças apo së bashku, mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse dhe as nuk do të thotë që ekzistenca e një apo disa prej këtyre zërave gjithnjë tregon se ekziston një pasiguri materiale.

Financiare

- Gjendje e detyrimeve neto ose e detyrimeve rrjedhëse neto.
- Hua me kushte fikse të cilat janë pranë maturimit, pa perspektivë reale rinovimi apo ripagimi; ose varësi e tepërt nga huatë afatshkurtra për të financuar aktive afatgjata.
- Tregues të ndërprerjes së mbështetjes financiare nga kreditorët.
- Flukse operacional negativ të parave evidentuar në pasqyrat financiare historike ose parashikuese.
- Përpjestime financiare kyçe negative.
- Humbje operationale të konsiderueshme ose rënie e ndjeshme e vlerës së aktiveve të përdorura për të gjeneruar flukse parash.
- Dividendë të paguar me vonesë ose ndërprerja e dhënies së tyre.
- Pamundësi për të paguar në afat kreditorët.
- Pamundësi për të respektuar kushtet e marrëveshjeve të huave.
- Kalim nga transaksione me kredi në transaksione me para në dorë me furnitorët.
- Pamundësi për të marrë financime për zhvillimin e produkteve esenciale të reja ose të investimeve të tjera të rëndësishme.

Të Veprimtarisë

- Synime të drejtuesve për të likjuar entitetin apo për të ndërprerë veprimtarinë.
- Largimi i drejtuesve kryesorë dhe mos zëvendësimi i tyre.

- Humbje e një tregu të rëndësishëm, e një të drejte ekskluzive, license, ose një furnitori kryesor.
- Vështirësi me të punësuarit.
- Mungesë e materialeve të rëndësishme.
- Hyrja në treg e një konkurenti të ri shumë të sukseshëm.

Të Tjera

- Mosrespektim i kërkesave të kapitalit ose kërkesave të tjera staturore, të tilla si kërkesat për aftësi paguese ose likuiditet për institucionet financiare.
- Proçese ligjore ose rregullatore të hapura ndaj entitetit, të cilat, nëse janë të suksesshme mund të çojnë në detyrime që ka të ngjarë të mos paguhen dot.
- Ndryshime në legjislacion ose në politikat e qeverisë të cilat mund të ndikojnë negativisht mbi entitetin.
- Fatkeqësi natyrore të pasiguruara ose pak të siguruara kur ato mund të ndodhin.

Rëndësia e ngjarjeve apo rrethanave të tilla shpesh mund të minimizohen nga faktorë të tjerë. Për shembull, pamundësia e entitetit për të mos kryer ripagesat normale të borxhit mund të kompensohet nga planet e drejtimit për të mbajtur konstant fluksin e parasë me mjete/mënyra alternative të tilla si, shitja e aktiveve, riskedulimi i ripagesës së huasë, ose marrja e kapitalit shtesë. Në të njëjtën mënyrë humbja e furnitorëve kryesorë mund të minimizohet nga disponueshmëria e një burimi tjetër furnizimi alternativ të përshtatshëm.

- A4. Procedurat e vlerësimit të rrezikut të parashikuara në paragrafin 10 ndihmojnë audituesin të përcaktojë nëse zbatimi nga drejtimi i bazës kontabel të vijimësisë ka të ngjarë apo jo që të jetë një çështje e rëndësishme dhe ndikimin e saj në planifikimin e auditimit. Këto procedura gjithashtu mundësojnë diskutimet në kohën e duhur me drejtimin, përfshirë diskutimin mbi planin e drejtimit dhe vendimet për secilën çështje të identifikuar të vijimësisë.

Konsiderata të Veçanta për Entitetet më të Vogla

- A5. Madhësia e një entiteti mund të ndikojë në aftësinë e tij për t'u bërë ballë kushteve të vështira. Entitetet e vogla janë të afta t'u përgjigjen më shpejt mundësive për t'u shfrytëzuar, por mund të kenë mungesë të rezervave për të mbështetur operacionet.

- A6. Kushte të një rëndësie të veçantë për entitetet e vogla përfshijnë rrezikun që bankat dhe huadhënës të tjerë të ndërpresin mbështetjen ndaj entitetit, si edhe humbja e mundshme një furnitori kryesor, klienti kryesor, punonjësi kyç, ose e drejta për të ushtruar veprimtarinë me licensë, me franshizë, ose me marrëveshje të tjera juridike.

Vigjilenca Gjatë Gjithë Auditimit për Evidencë Auditimi rreth Ngjarjeve apo Kushteve (Ref: Para. 11)

- A7. SNA 315 (i rishikuar) kërkon që audituesi të rishikojë vlerësimin e rrezikut të audituesit dhe të modifikojë përkatësisht procedurat e mëtejshme të planifikuara të auditimit kur merret evidencë auditimi shtesë gjatë kryerjes së auditimit të cilat ndikojnë në vlerësimin e rrezikut të auditimit.¹⁰ Në qoftë se identifikohen ngjarje apo kushte që hedhin dyshime mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi pasi janë kryer prej audituesit vlerësimet e rrezikut të auditimit, si shtesë e kryerjes së procedurave të parashikuara në paragrafin 16, është e nevojshme që audituesi të rishikojë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale. Ekzistenca e këtyre ngjarjeve apo kushteve gjithashtu mund të ndikojë në natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të mëtejshme të auditimit në përgjigje të rreziqeve të vlerësuara. SNA 330¹¹ parashikon kërkesat dhe jep udhëzime për këtë çështje.

Shqyrtimi i Vlerësimeve të Drejtimit

Vlerësimi i Drejtimit dhe Analizat Mbështetëse dhe Shqyrtimi i Audituesit (Ref: Para. 12)

- A8. Vlerësimi i drejtimit për aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi është pjesë e rëndësishme e punës së audituesit për zbatimin nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë.
- A9. Nuk është përgjegjësia e audituesit të plotësojë mungesën e analizave të drejtimit. Pavarësisht nga kjo, në disa rrethana, mungesa e analizave të hollësishme prej drejtimit për të mbështetur vlerësimin e tij mund të mos e ndalojë audituesin për të konkluduar nëse përdorimi nga drejtimi i bazës kontabël të vijimësisë është apo jo i përshtatshëm për rrethanat. Për shembull, kur ka një ecuri të operacioneve me fitim dhe lehtësi për të siguruar burime financiare, drejtimi mund të përgatisë vlerësimin e tij pa bërë analiza të hollësishme. Në këtë rast, shqyrtimi prej audituesit për përshtatshmërinë e vlerësimit të drejtimit mund të kryhet pa bërë procedura shqyrtimi të hollësishme në qoftë se procedurat e tjera të auditimit janë të mjaftueshme për t'i mundësuar audituesit të konkludojë nëse zbatimi nga drejtimi i bazës kontabël të vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare është apo jo i përshtatshëm për rrethanat.

¹⁰ SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 31.

¹¹ SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara*.

A10. Në rrethana të tjera, shqyrtimi i vlerësimit të drejtimit mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, siç parashikohet në paragrafin 12, mund të përmbajë shqyrtimin e procesit të ndjekur nga drejtimi në bërjen e vlerësimit të tij, supozimet mbi bazën e të cilave është bërë vlerësimi si dhe planet e drejtimit për veprimet në të ardhmen dhe nëse planet e drejtimit janë të zbatueshme për rrethanat.

Periudha e Vlerësimit të Drejtimit (Ref: Para. 13)

A11. Shumica e kuadrove të raportimit financiar kërkojnë një vlerësim të veçantë prej drejtimit duke specifikuar periudhën për të cilën drejtimit i kërkohet që të marrë parasysh të gjithë informacionin e disponueshëm.¹²

Konsiderata specifike për njësitë më të vogla (Ref: Para. 12-13)

A12. Në shumë raste, drejtimi i entiteteve më të vogla mund të mos përgatisë vlerësim të hollësishëm mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, por në vend të kësaj të mbështetet në njohuritë e thella ndaj biznesit dhe perspektivat paraprake për të ardhmen. Megjithatë, në përputhje me kërkesat e këtij SNA-je, audituesi ka nevojë të shqyrtojë vlerësimin e drejtimit mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Për entitete më të vogla, është e përshtatshme të diskutohet me drejtimin për mjetet dhe financimet afatgjata të entitetit, duke patur parasysh se pohimet e drejtimit duhet të mbështeten me evidencë të dokumentuar e të mjaftueshme, të cilat nuk bien ndesh me njohuritë që audituesi zotëron për entitetin. Për këtë, kërkesat në paragrafin 13, që audituesi i kërkon drejtimit të zgjerojë vlerësimin e tij, për shembull, mund të kënaqen me diskutimin, marrjen në pyetje dhe inspektimin e dokumentacionit mbështetës, për shembull, porositë e marra për furnizime në të ardhmen, të vlerësuara për zbatueshmërinë e tyre ose ndryshe qëndrueshmërinë.

A13. Mbështetja e vazhdueshme nga pronar-drejtuësit është shpesh e rëndësishme për aftësinë e entiteteve më të vogla për të vazhduar në vijimësi. Kur një entitet i vogël kryesisht financohet nga huaja e dhënë nga pronari-drejtuësi, është e rëndësishme që këto fonde të mos tërhiqen. Për shembull, vazhdimësia në vështirësi financiare për një entitet të vogël mund të varet nga kalimi i huasë së pronarit-drejtuësit tek entiteti për llogari të bankave ose kreditorëve të tjerë, ose mbështetja e pronarit-drejtuësit të huasë për entitetin duke dhënë garanci si kolateral me aktivet personale të tija apo të sajat. Në këto rrethana, audituesi merr evidencën e dokumentuar e të përshtatshme për kalimin e huasë së pronarit-drejtuësit ose për garancinë. Kur entiteti është i varur nga mbështetja shtesë prej pronarit-drejtuësit, audituesi duhet të shqyrtojë aftësinë e pronarit-drejtuësit për të plotësuar detyrimet në bazë të marrëveshjes së mbështetjes. Më tej, audituesi

¹² Për shembull, SNK 1 përcakton këtë si një periudhë që është të paktën, por nuk është e kufizuar vetëm me këtë, dymbëdhjetë muaj nga mbyllja e periudhës raportuese.

duhet të kërkojë konfirmime me shkrim për kushtet dhe afatet që shoqërojnë këtë mbështetje dhe synimet apo mirëkuptimin e pronarit-drejtesit.

Periudha Përtej Vlerësimit të Drejtimit (Ref: Para. 15)

- A14. Siç kërkohet nga paragrafi 11, audituesi duhet të jetë i vëmendshëm mbi mundësinë e ekzistencës së ngjarjeve të njohura, qoftë të planifikuara ose jo, apo kushteve që mund të ndodhin përtej periudhës së vlerësimit të zbatuar nga drejtimi dhe që mund të sjellin dyshime në lidhje me përshtatshmërinë e zbatimit të hipotezës së vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare. Meqenëse shkalla e pasigurisë që lidhet me rezultatet e një ngjarjeje apo kushti rritet sa më e largët të jetë kjo ngjarje apo rrethanë në të ardhmen, në marrjen në konsideratë të ngjarjeve apo kushteve të tilla duhet që treguesit e ekzistencës së këtyre ngjarjeve apo kushteve duhet të jenë të dukshëm/ndjeshëm përpara se audituesi të ndërmarrë veprime të mëtejshme. Në qoftë se identifikohen të tilla ngjarje apo kushte, audituesit mund t'i lindë nevoja të kërkojë që drejtimi të përcaktojë rëndësinë potenciale të këtyre ngjarjeve apo kushteve në vlerësimin e tij mbi hipotezën e vijimësisë. Në këto rrethana, zbatohen procedurat e paragrafit 16.
- A15. Audituesi nuk ka përgjegjësinë të hartojë procedura auditimi të tjera përveçse se të marrë në pyetje drejtimin për të identifikuar ekzistencën e ngjarjeve apo kushteve të cilat krijojnë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi në periudhat përtej periudhës së vlerësuar nga drejtimi, e cila, siç është trajtuar në paragrafin 13, duhet të jetë të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e pasqyrave financiare.

Procedurat e Mëtejshme të Auditimit kur Janë Identifikuar Ngjarje apo Rrethana (Ref: Para. 16)

- A16. Procedurat e auditimit të cilat ndërmerren përkatësisht me kërkesat e paragrafit 16, mund të përfshijnë sa më poshtë vijon:
- Analizimi dhe diskutimi i flukseve të parasë, fitimit dhe parashikimeve të tjera të rëndësishme të drejtimit.
 - Analizimi dhe diskutimi i pasqyrave financiare të ndërmjetme më të fundit të disponueshme.
 - Rishqyrtimi i afateve të obligacioneve dhe marrëveshjeve të huave dhe përcaktimi nëse ato janë shkelur.
 - Leximi i procesverbaleve të asamblesë së aksionerëve, të personave të ngarkuar me qeverisjen dhe komitetet e tjera përkatëse duke u përqëndruar në problemet që kanë të bëjnë me vështirësitë financiare.

- Kërkim informacioni ndaj këshilltarit ligjor të entitetit në lidhje me ekzistencën e proceseve gjyqësore dhe padive dhe me përshtatshmërinë e vlerësimit të drejtimit mbi rezultatet dhe ndikimin e tyre financiar.
- Konfirmimi i ekzistencës, ligjshmërisë dhe zbatueshmërisë së dispozitave ligjore për të siguruar ose ruajtur mjetet financiare me palë të treta dhe të lidhura, dhe vlerësimi i aftësisë financiare të këtyre palëve për të ofruar fonde shtesë.
- Marrja në konsideratë e planeve të entitetit në lidhje me plotësimin e porosive të pakryera të klientëve.
- Kryerja e procedurave të auditimit në lidhje me ngjarjet e mëvonshme për të identifikuar ato që ose kundërshtojnë ose ndikojnë në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi.
- Konfirmimi i ekzistencës, kushteve dhe përshtatshmërisë së huamarrjeve.
- Marrja dhe rishqyrtimi i raporteve të autoriteteve rregullatore.
- Përcaktimi i përshtatshmërisë së mbështetjes për çdo shitje të planifikuar të aktiveve.

Shqyrtimi i Planeve të Drejtimit për Veprime në të Ardhmen (Ref: Para. 16(b))

A17. Shqyrtimi i planeve të drejtimit për veprime në të ardhmen duhet të përfshijë pyetjen e drejtuesve për planet e tyre për veprime në të ardhmen, përfshirë, për shembull, planet e tyre për të likuiduar aktive, për të marrë hua para ose për të ristrukturuar borxhin, për të reduktuar ose shtyrë shpenzimet, ose për të zmadhuar kapitalin.

Periudha e Vlerësimit e Drejtimit (Ref: Para. 16(c))

A18. Si shtesë të procedurave të kërkuara në paragrafin 16(c) audituesi krahason:

- Informacionet financiare parashikuese për periudhat e mëparshme më të fundit me informacionet financiare historike përkatëse; dhe
- Informacionin për parashikimin financiar për periudhën ushtrimore me rezultatet e arritura deri në momentin kur bëhet krahasimi.

A19. Kur supozimet e drejtimit përfshijnë mbështetjen e vazhdueshme nga palë të treta, qoftë nëpërmjet kalimit të huave, angazhimeve për të mbajtur apo për të dhënë financime shtesë, apo garanci dhe kjo mbështetje është e rëndësishme për aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, audituesi duhet të marrë në konsideratë të kërkojë konfirmime me shkrim (përfshirë kushtet dhe afatet) nga

ato palë të treta dhe të marrë evidencë mbi aftësinë e tyre për të dhënë këtë mbështetje.

Deklarimet me shkrim (Ref: Para. 16(e))

A20. Audituesi mund të konsiderojë të përshtatshme që të sigurojë deklarime specifike me shkrim përtej atyre që kërkohen në paragrafin 16, në mbështetje të evidencës së siguruar të auditimit lidhur me planet e drejtimit në lidhje me vlerësimin e vijimësisë dhe realizueshmërinë e këtyre planeve.

Konkluzionet e Audituesit

Pasiguria Materiale e Lidhur me Ngjarje ose Kushte që Mund të Hedhin Dyshime të Rëndësishme mbi Aftësinë e Entitetit për të Vazhduar në Vijimësi (Ref: Para. 18)

A21. Fraza “pasiguri materiale” është përdorur në SNK 1 kur janë diskutuar pasiguritë që lidhen me ngjarje apo kushte të cilat hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi për të cilat jepen informacione në pasqyrat financiare. Në disa kuadro të tjera të raportimit financiar për rrethana të ngjashme përdoret fraza “pasiguri e rëndësishme”.

Mjaftueshmëria e Informacioneve shpjeguese kur janë Identifikuar Ngjarje ose Kushte dhe Ekziston një Pasiguri Materiale

A22. Paragrafi 18 shpjegon se një pasiguri materiale ekziston kur shtrirja e ndikimit të mundshëm të ngjarjeve ose kushteve dhe probabiliteti i ndodhjes është i tillë, që dhënia e informacionit të përshtatshëm është i nevojshëm për të patur një paraqitje të drejtë (për kuadrot e paraqitjes së drejtë) ose që pasqyrat financiare të mos jenë çorientuese (për kuadrot e pajtueshmërisë). Nga paragrafi 18, audituesi kërkohet të nxjerrë përfundimin nëse ekziston një pasiguri materiale pavarësisht nëse ose si kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar e përkufizon një pasiguri materiale.

A23. Paragrafi 19 kërkon që audituesi të përcaktojë nëse shënimet në pasqyrat financiare adresojnë çështjet e përshkruara në këtë paragraf. Ky përcaktim bëhet pavarësisht vlerësimit që audituesi bën në lidhje me mjaftueshmërinë e informacionit shpjegues për një pasiguri materiale, të kërkuar nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar informacioni shpjegues i kërkuar nga disa kuadro të raportimit financiar që janë në shtesë të çështjeve të përcaktuara në paragrafin 19, mund të përfshijnë informacion shpjegues për:

- Vlerësimin e drejtimit për ngjarje ose kushte të rëndësishme që lidhen me aftësinë e entitetit për të përmbushur detyrimet e tij; ose
- Gjykime të rëndësishme të bëra nga drejtimi si pjesë e vlerësimit të tij për mundësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi.

Disa kuadro të raportimit financiar mund të japin udhëzime lidhur me konsideratat e drejtimit rreth gjerësisë së ndikimit të mundshëm të ngjarjeve dhe kushteve të rëndësishme dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre.

Mjaftueshmëria e Informacioneve kur janë Identifikuar Ngjarje ose Kushte por Nuk Ekziston Pasiguri Materiale (Ref: Para. 20)

A24. Edhe nëse nuk ekziston pasiguri materiale, paragrafi 20 kërkon që audituesi të vlerësojë nëse, në funksion të kërkesave të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, pasqyrat financiare japin informacione të mjaftueshme rreth këtyre ngjarjeve dhe kushteve që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Disa kuadro të raportimit financiar mund të adresojnë informacione rreth:

- Ngjarjeve ose kushteve kryesore;
- Vlerësimin të drejtimit për rëndësinë e këtyre ngjarjeve apo kushteve në lidhje me aftësinë e entitetit për të përmbushur detyrimet e tij;
- Planet e drejtimit për të zvogëluar efektin e këtyre ngjarjeve ose kushteve; ose
- Gjykimeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi si pjesë e vlerësimit të aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi.

A25. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, vlerësimi i audituesit përsa i përket paraqitjes së drejtë përfshin shqyrtimin e paraqitjes së përgjithshme, të strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare dhe faktit nëse pasqyrat financiare përfshirë shënimet përkatëse, paraqesin transaksionet dhe ngjarjet mbështetëse në një mënyrë që të arrihet paraqitja¹³ e drejtë. Në varësi të fakteve dhe rrethanave, audituesi mund të përcaktojë që informacionet shtesë janë të nevojshme për një paraqitje të drejtë. Ky për shembull, mund të jetë rasti kur janë identifikuar ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi, por audituesi bazuar në evidencën e auditimit të siguar, arrin në përfundimin që nuk ekziston pasiguri materiale dhe informacionet lidhur me këto rrethana, janë të kërkuara shprehimisht nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar.

Pasojat në Raportin e Audituesit

Përdorimi i Bazës Kontabël të Vijimësisë është i Papërshtatshëm (Ref: Para. 21)

¹³ SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafi 14.

- A26. Në qoftë se pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën kontabël të vijimësisë por, sipas gjykimit të audituesit, përdorimi nga drejtimi i vijimësisë në pasqyrat financiare është i papërshtatshëm, për audituesin zbatohet kërkesa e paragrafit 21 që të shprehë një opinion kundër pavarësisht nëse pasqyrat financiare përfshijnë apo jo informacione të dhëna për papërshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi i bazës kontabël të vijimësisë.
- A27. Kur përdorimi i bazës kontabël të vijimësisë nuk është i përshtatshëm për rrethanat, drejtimi të entitetit i kërkohet, apo ai ka zgjedhur, të përgatisë pasqyrat financiare mbi një bazë tjetër alternative (për shembull, mbi bazën e likuidimit). Audituesi duhet të jetë në gjendje që të kryejë auditimin e këtyre pasqyrave financiare, me kusht që audituesi të përcaktojë se një bazë tjetër e kontabilitetit është e pranueshme për rrethanat. Audituesi mund të shprehë një opinion pa rezervë për këto pasqyra financiare, nëse ka informacione të dhëna të përshtatshme, por duke marrë në konsideratë si të përshtatshme ose të nevojshme të përfshijë një paragraf që thekson çështjen në raportin e audituesit SNA 706 (i rishikuar)¹⁴ për të tërhequr vëmendjen e përdoruesit mbi këtë bazë alternative kontabël dhe arsyet për të përdorur atë.

Përdorimi i Bazës kontabël të Vijimësisë është i Përshtatshëm por Ekziston një Pasiguri Materiale (Ref: Para. 22-23)

- A28. Identifikimi i një pasigurie materiale është një çështje që është e rëndësishme për kuptimin nga ana e përdoruesve të pasqyrave financiare. Përdorimi i një seksioni të veçantë që përfshin referimin e faktit që ekziston një pasiguri materiale lidhur me çështjen e vijimësisë, shërben për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në lidhje me këto rrethana.
- A29. Shtojca e këtij SNA-je, jep ilustrime të deklaratave që kërkohen të përfshihen në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare, kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kur përdoret një kuadër i zbatueshëm i raportimit financiar, i ndryshëm nga SNRF-të, elementet ilustruese të paraqitura në Shtojcën e këtij SNA-je mund të jetë e nevojshme të përshtaten, për të reflektuar zbatimin e kuadrove të tjera të raportimit financiar në përputhje me rrethanat.
- A30. Paragrafi 22 përcakton minimumin e informacionit që kërkohet të paraqitet në raportin e audituesit për secilën nga rrethanat e përshkruara. Audituesi mund të kërkojë informacione shtesë për të plotësuar deklaratat e kërkuara për shembull, për të shpjeguar:

¹⁴ SNA 706(i rishikuar), *Paragrafet që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafet për Çështje të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur.*

- Që ekzistenca e një pasigurie materiale është thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare;¹⁵ ose
- Mënyrën si ka qenë adresuar çështja në auditim (Shiko gjithashtu paragrafin A1).

Në Pasqyrat Financiare janë dhënë Informacionet e Duhura shpjeguese për një Pasiguri Materiale (Ref: Para. 22)

A31. Ilustrimi 1 i Shtojcës së këtij SNA-je është një shembull i raportit të audituesit, kur audituesi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi i bazës kontabël të vijimësisë, kur ekziston një pasiguri materiale dhe për të janë dhënë informacionet e duhura shpjeguese në pasqyrat financiare. Shtojca e SNA 700 (i rishikuar) përfshin gjithashtu, një formulim ilustrues që duhet të përfshihet në raportin e audituesit për të gjitha entitetet në lidhje vijimësinë, për të përshkruar përgjegjësitë përkatëse të atyre që janë përgjegjës për pasqyrat financiare dhe të audituesit në lidhje me vijimësinë.

Në Pasqyrat Financiare Nuk janë dhënë Informacionet e Duhura shpjeguese për një Pasiguri Materiale (Ref: Para. 23)

A32. Ilustrimi 2 dhe 3 i Shtojcës së këtij SNA-je janë shembuj të raporteve të audituesit që përmbajnë përkatësisht një opinion me rezervë dhe opinion kundër, kur audituesi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë, kur në pasqyrat financiare nuk janë dhënë informacionet e duhura për një pasiguri materiale.

A33. Në situata që përfshijnë disa pasiguri materiale që janë të rëndësishme për pasqyrat financiare në tërësi, audituesi mund t'a konsiderojë të përshtatshme në raste shumë të veçanta të shprehë refuzim për të dhënë opinion në vend që të përfshijë deklaratimet e kërkuara nga paragrafi 22. SNA 705 (i rishikuar) jep udhëzime për këtë çështje.¹⁶

Komunikimi me Rregullatorët (Ref: Para. 22-23)

A34. Kur një auditues i një entiteti rregullator konsideron që mund të jetë e nevojshme të përfshijë një referencë për çështjet e vijimësisë në raportin e audituesit, audituesi mund të ketë detyrë të komunikojë me autoritetet rregullatore, zbatuese ose mbikqyrëse në fuqi.

Drejtimi nuk Pranon të Bëjë apo të Zgjerojë Vlerësimin e Tij (Ref: Para. 24)

¹⁵ SNA 706 (i rishikuar), paragrafi A2

¹⁶ SNA 705 (i rishikuar), paragrafi 10

- A35. Në rrethana të caktuara, audituesi mund të besojë se është e nevojshme t'i kërkojë drejtimit të bëjë ose të zgjerojë vlerësimin e tij. Në rast se drejtimi është i papredispozuar për ta bërë këtë, është e përshtatshme që audituesi të shprehë opinion me rezervë ose refuzim për të dhënë opinion në raportin e audituesit, pasi audituesi e ka të pamundur të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me përdorimin nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare, si evidencë auditimi për ekzistencën e planeve që zbaton drejtimi ose për ekzistencën e faktorëve të tjerë lehtësues.

Shtojca

(Ref. Para. A29, A31-A32)

Ilustrime të Raportit të Audituesit Lidhur me Vijimësinë

- Ilustrimi 1: Raporti i audituesit përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka arritur në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale dhe informacionet shpjeguese në pasqyrat financiare janë të mjaftueshme.
- Ilustrimi 2: Raporti i audituesit përmban një opinion me rezervë, kur audituesi ka arritur në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale dhe pasqyrat financiare kanë anomali materiale, për shkak të informacioneve shpjeguese të pamjaftueshme.
- Ilustrimi 3: Raporti i audituesit përmban një opinion kundër, kur audituesi ka arritur në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale dhe në pasqyrat financiare mungojnë informacionet përkatëse shpjeguese lidhur me një pasiguri materiale.

Ilustrimi 1: Opinioni i pamodifikuar kur ekziston një pasiguri materiale dhe informacionet shpjeguese në pasqyrat financiare janë të mjaftueshme.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohet se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600¹⁷).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210¹⁸.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar

¹⁷ SNA 600, *Konsiderata të veçanta – Auditimi i pasqyrave financiare të grupit (duke përfshirë punën e audituesit të entitetit të kontrolluar)*

¹⁸ SNA 210, *Rënia dakord me kushtet e angazhimit të auditimit*

veprimtarinë. Në pasqyrat financiare gjenden informacionet e duhura për pasigurinë materiale.

- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.
- Ata që janë përgjegjës për mbikqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar sipas legjislacionit lokal.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Shoqërisë Tregtare ABC [ose një Adresë Tjetër e Duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁹

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, *(ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për)*, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 20X1, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në *[juridiksionin]*, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në

¹⁹Nëntitulli *Raporti mbi Pasqyrat Financiare* është i panevojshëm në rrethana kur nëntitulli i dytë “Raporti mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore” nuk është i mundur.

përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Pasiguritë Materiale Lidhur me Vijimësinë

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin XXX të pasqyrave financiare, i cili tregon që Shoqëria pësoi një humbje neto prej ZZZ gjatë vitit që mbyllet në 31 Dhjetor 20X1, dhe ose pas kësaj date, detyrimet korrente tejkaluan aktivet saj totale për YYY. Siç është deklaruar në shënimin 6, këto ngjarje dhe kushte së bashku me ngjarje dhe kushte të tjera siç përcaktohen në shënimin 6, tregojnë që ekziston një pasiguri materiale e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Opinioni jonë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qenë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qenë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë. Përveç çështjeve të përshkruara në Seksionin *Pasiguritë Materiale Lidhur me Vijimësinë*, ne kemi përcaktuar çështjet e përshkruara më poshtë si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit që jepen në SNA 720 (i rishikuar) shiko Ilustrimin 1 në shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare²⁰

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar)²¹.]

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

²⁰Gjatë gjithë këtyre raporteve ilustruese të audituesit, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të jetë e nevojshme të zëvendësohen nga terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

²¹Paragrafi 34 dhe 39 i SNA 700 (i rishikuar) kërkon që në raportin e audituesit të përfshihet një paragraf për të gjitha entitetet në lidhje me vijimësinë për të përshkruar përgjegjësitë përkatëse të atyre që janë përgjegjës për pasqyrat financiare dhe të audituesit për vijimësinë.

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin, përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri].

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit]

[Data]

Ilustrimi 2: Opinion me Rezervë Kur Ekziston një Pasiguri Materiale dhe Informacionet në Pasqyrat Financiare kanë anomali materiale për Shkak të Informacioneve shpjeguese të pamjaftueshme

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Shënimi yy në pasqyrat financiare trajton rëndësinë e marrëveshjeve të financimit, skadimin dhe marrëveshjet e financimit në total. Megjithatë, pasqyrat financiare nuk përfshijnë trajtime mbi ndikimin ose disponueshmërinë e rifinancimit dhe nuk e karakterizojnë këtë situatë si pasiguri materiale.

- Pasqyrat financiare kanë anomali materiale për shkak të informacioneve shpjeguese të pamjaftueshme ose të pasigurisë materiale. Është shprehur një opinion me rezervë pasi audituesi ka arritur në përfundimin që efektet e informacioneve shpjeguese të pamjaftueshme në pasqyrat financiare janë materiale por jo të përhapura.
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtëm me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe çështja që ka çuar në opinionin me rezervë në pasqyrat financiare ka ndikim edhe në informacionet e tjera.
- Ata që janë përgjegjës për mbikqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar sipas legjislacionit lokal.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Shoqërisë Tregtare ABC [ose një Adresë Tjetër e Duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare²²

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të informacioneve të paplota të informacionit të referuar në seksionin *Bazat për Opinionin me Rezervë*, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për), të pozicionit financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 20X1, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin me Rezervë

²²Nëntitulli *Raportit mbi Pasqyrat Financiare* është i panevojshëm në rrethana kur nëntitulli i dytë “Raportit mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore” nuk është i mundur.

Siç është trajtuar në Shënimin yy, marrëveshjet e financimit të shoqërisë përfundojnë kështu që shumata e papaguara duhet të paguhet që nga data 19 Mars 20X2. Shoqëria nuk ka qenë e aftë të arrijë rinegociime ose të sigurojë financime alternative. Kjo situatë tregon që ekziston një pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Pasqyrat financiare nuk kanë informacionet e duhura shpjeguese për këtë çështje.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Informacione të Tjera [ose nëqoftëse është i përshtatshëm një titull tjetër si “Informacione të tjera që Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit në lidhje me to]

[Raportimi në përputhje me SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 6 në shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar). Paragrafi i fundit i seksionit të informacioneve të tjera në Ilustrimin 6 do të personalizohet për të përshkruar çështjen specifike që ka çuar në opinionin me rezervë dhe që ka ndikim në informacionet e tjera.]

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qenë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qenë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë. Përveç çështjeve të përshkruara në Seksionin *Bazat për Opinionin me Rezervë*, ne kemi përcaktuar çështjet e përshkruara më poshtë si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare²³

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar)²⁴.]

²³Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

²⁴Paragrafi 34 dhe 39 i SNA 700 (i rishikuar) kërkon që në raportin e audituesit të përfshihet një paragraf për të gjitha entitetet në lidhje me vijimësinë për të përshkruar përgjegjësitë përkatëse të atyre që janë përgjegjës për pasqyrat financiare dhe të audituesit për vijimësinë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin, përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri].

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit]

[Data]

Ilustrimi 3: Opinion Kundër Kur Ekziston një Pasiguri Materiale dhe nuk është shpjeguar në shënimet e pasqyrave financiare

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë dhe Shoqëria po konsideron falimentimin. Në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë informacionet përkatëse lidhur me një pasiguri materiale.

Një opinion kundër është shprehur sepse efektet e një mungese të tillë në pasqyrat financiare janë materiale dhe të përhapura.

- Audituesit nuk i kërkohet, ose nuk ka vendosur të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe çështja që ka çuar në opinionin kundër mbi pasqyrat financiare ka ndikim edhe në informacionet e tjera.
- Ata që janë përgjegjës për mbikqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar sipas legjislacionit lokal.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Shoqërisë Tregtare ABC [ose një Adresë Tjetër e Duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare²⁵

Opinion kundër

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, për shkak të heqjes së informacionit të përmendur në seksionin e raportit tonë *Bazat për Opinionin Kundër*, pasqyrat financiare bashkëlidhur nuk paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose nuk japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 20X1, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin Kundër

Marrëveshjet e financimit të shoqërisë kanë përfunduar dhe shumat e papaguara janë të pagueshme në 19 Mars 20X2. Shoqëria nuk ka qenë në gjendje të arrijë rinegocime ose të sigurojë financime alternative dhe është duke konsideruar paraqitjen për shpalljen e falimentimit. Kjo situatë tregon që ekziston një pasiguri materiale që mund të hedhë

²⁵Nëntitulli *Raporti mbi Pasqyrat Financiare* është i panevojshëm në rrethana kur nëntitulli i dytë “Raporti mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore” nuk është i mundur.

dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Pasqyrat financiare nuk kanë informacionet e duhura shpjeguese për këtë fakt.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë kundër.

Informacione të Tjera [ose nëqoftëse është i përshtatshëm një titull tjetër si “Informacione të tjera që Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit në lidhje me to]

[Raportimi në përputhje me SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 7 në shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar). Paragrafi i fundit i seksionit të informacioneve të tjera në Ilustrimin 7 do të personalizohej për të përshkruar çështjen specifike që ka çuar në opinionin kundër dhe që ka ndikim në informacionet e tjera.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare²⁶

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar)]²⁷.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Ortaku i angazhimit për auditimin, përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri].

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

²⁶Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

²⁷Paragrafi 34 dhe 39 i SNA 700 (i rishikuar) kërkon që në raportin e audituesit të përfshihet një paragraf për të gjitha entitetet në lidhje me vijimësinë për të përshkruar përgjegjësitë përkatëse të atyre që janë përgjegjës për pasqyrat financiare dhe të audituesit për vijimësinë.

VIJIMËSIA

[Adresa e Audituesit]

[Data]